

A dëshiron të mësosh se si prodhohen gjërat, nga ideja deri te malli i gatshëm?

A dëshiron të punosh me pajisje të avancuar kompjuteristike?

A dëshiron të bashkëpunosh me të tjerët, por si specialist i lëmisë tënde?

A dëshiron të punosh në një lëmi ndërkombëtare?

A dëshiron të provosh të punosh që nga koha e gjimnazit?

Në atë rast, Programi industrial mund të jetë për ty.

Te Programi industrial do të mësosh dituri të gjëra për një lëmi që ndryshon gjithnjë e më tepër. Punët industriale janë ndryshuar shumë për një kohë të shkurtër, dhe gjatë tërë kohës shfaqen maqineri të reja dhe mëyra të reja të prodhimit. Do të mësosh për teknikë kompjuteristike dhe të informacionit edhe për materiale dhe mjete të ndryshme. Do të mendosh poashtu edhe për çështje që janë shumë të flakta tash për tash, siç janë ato të ambientit dhe të riciklimit.

Lëmia e industrisë është ndërkombëtare. Për ty që dëshiron të punosh në industri, është mirë të keshë kuptim dhe interesim për kultura të tjera. Mirë është poashtu edhe të keshë dituri gjuhësore. Për këtë arsye, te Programi industrial do të jepet mundësia që të thellohesh te gjuhët e ndryshme.

Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin industrial mund të kërkosh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga kurset që i ke zgjedhur. Në disa raste të jepet mundësia që fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast do të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Nëse dëshiron, mund të zgjedhësh që të vazhdosh studimet pas gjimnazit. Mundesh për shembull të zgjedhësh një kualifikim të Fakulteti i profesioneve. Mund të zgjedhësh poashtu që të vazhdosh studimet te univeristet dhe fakultetet. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve se cilat kurse gjimnaziale duhet që të zgjedhësh që të bëhesh me kompetencë.

Punë ku mund të pranohesh

Pasi që i ke përfunduar studimet te Programi industrial mundesh për shembull të kërkosh punë si CNC-operator, teknik global, mekatronik, teknik modelesh, konstruktor mostrash, operator i proceseve, sallduas ndërkombëtar, teknik druri, teknik mirëmbajtjesh dhe teknik guri.

Përmbajtja e Programit

Programi industrial përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurset e tjera janë veçanta për Programin industrial. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi nuk ka drejtime ndërkombëtare. Çdo shkollë i ka drejtimet e veta të përshtatura sipas industrive që gjinden në rajon. Shembull për drejtimet janë industria procesuale kimike, industria e masave dhe të letrave, industria e çelikut, industria e tekstileve, industria e drunjëve, industria e gurëzve dhe industria e puntorive.

Drejtimi që të intereson ty ndoshta nuk gjindet te rrethina yte. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve në rast se drejtimi është i përfshirë te programi shtetëror. Në atë rast do të keshë mundësi që të pranohesh tek drejtimi.

Kontakte me tregun e punës

Te Programi elektrik do të kesh kontakte me tregun e punë që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Pasi që Programi industrial te shkolla yte është i përshtatur siaps industrive të pranishme të rajonit, do të mësosh se si duket realiteti për pikërisht atë pjesë të lëmisë që e studijon në shkollë. APU është poashtu edhe një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përdorësh kur do të kërkosh punë. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Ardhmëri dhe punë

Tani nuk ka punë me të njëjtën sasi siç ka pasur para disa viteve. Kjo varret prej faktit që shumë punë sot bëhen nga kompjuterë dhe maqineri. Njëkohësisht që industria ka nevojë për njerëz të rinjë dhe me kualifikim të mirë që dijnë të menaxhojnë maqineritë dhe që e dijnë se çka i nevojitet industrisë moderne. Është e vështirë të thuhet se ne rast se do të bëhet e lehtë apo e vështirë për ty që të punësohesh pas përfundimit të Programit industrial. Kjo varret nga drejtimi që e zgjedh dhe në rast se lëmia ka apo s'ka sukses gjatë atij vitit kur ti e mabron gjimnazin.